



Akses në procedurën e azilit





This Project is funded by the European Union

Ky dokument u botua falë asistencës së Bashkimit Evropian nëpërmjet projektit "Mbështetje rajonale për menaxhimin e migracionit me fokus te mbrojtja në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi - Faza II". Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e EASO-s dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Kjo broshurë e vogël mund të ruhet si një rikujtesë e vazhdueshme për detyrimet thelbësore të zyrtarëve përgjegjës të kontaktit të parë gjatë punës së tyre me persona të cilët dëshirojnë të aplikojnë për mbrojtje ndërkombëtare.

Broshura shpjegon procesin e identifikimit të personave të cilët dëshirojnë të aplikojnë për mbrojtje, si edhe për sigurimin e garancive dhe mbështetjen procedurale përkatëse.

Çdo qenie njerëzore do të vlerësohet dhe respektohet.

Urgjencat shëndetësore dhe nevojat bazë janë çështjet parësore për t'u trajtuar.

Akses në procedurën e azilit

1 Çdokush mund të jetë refugjat

2 Të gjithë kanë të drejtën e mbrojtjes kundër *kthimit*

3 Personat e cenueshëm duhet të identifikohen dhe të mbështeten në mënyrë adekuate

4 Përparësi gëzon interesi më i lartë i fëmijës kur bëhet fjalë për çështje që lidhen me ta

5 Kushdo që dëshiron të aplikojë për mbrojtje ndërkombëtare duhet të informohet për të drejtën për ta bërë këtë

6 Çdokush ka të drejtë të aplikojë për mbrojtje ndërkombëtare

7 Çdo sinjal ose shprehje e frikës mund të kuptohet si kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare

8 Aplikantët për mbrojtje ndërkombëtare nuk duhet të penalizohen për shkak të hyrjes ose pranisë së tyre të paligjshme

9 Çdo aplikim duhet të regjistrohet ose t'i referohet për regjistrim autoritetit përgjegjës

10 Parimi i *moskthimit* duhet të garantohet, edhe kur një person nuk aplikon për azil



Roli juaj në sigurimin e trajtimit për mbrojtje ndërkombëtare

Bëhuni proaktiv për sigurimin e trajtimit të procedurës së azilit

- Çdokush zotëron të drejtën për të kërkuar azil
- Ekzistojnë shumë mënyra për të shprehur nevojat për mbrojtje, sesa thjesht duke përmendur fjalën „azil“!
- Kur jeni në dyshim, merrni me mend se personi po kërkon azil

Kërkoni indikacione dhe bëhuni mendjehapur

- Çdokush mund të jetë refugjat
- Kushtojini vëmendje dobësive

Bëhuni të respektueshëm dhe mos paragjykoni

- Mos diskriminoni
- Nuk jeni ju përgjegjës për të vendosur nëse personi është apo jo refugjat
- Aplikantët nuk duhet të penalizohen për shkak të hyrjes ose qëndrimit të tyre të paligjshëm

Kushtojini vëmendje qëndrimit dhe mënyrës së të folurit të trupit tuaj dhe mënyrës se si komunikoni

Treguesit për një person që mund të aplikojë për mbrojtje ndërkombëtare

Cili është personi

Nga vjen personi

Çfarë deklaron / nga se frikësohet personi

- Vrasja apo ekzekutimi
- Persekutimi
- Torturimi
- Lufta
- Kthimi

Çfarë dëshiron personi

- Ndihmë
- Mbrojtje
- Të takojë një përfaqësues të OKB / UNHCR / avokat

Cilat janë detajet që mund të vëzhgoni (në pamje dhe sjellje)

- Afrimi / shmangia e zyrtarit përgjegjës
- Frika, stresi ose heshtja e pazakontë
- Sjellja dhe / ose qëndrimi i pazakontë
- Pamja (lëndimet, plagët, veshmbathjet, sendet personale, etj)

Çfarë duhet të bëjmë më tej

Jepni informacion rreth mundësisë për të aplikuar për azil

- Sigurohuni që jeni i vetëdijshëm për informacionin që duhet dhënë në bazë të praktikës shtetërore

Ndërgjegjësohuni mbi qëllimin për të aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare

- Nëse një person shpreh me çfarëdo lloj mënyre dëshirë për të aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare, kjo konsiderohet se ka bërë një kërkesë
- Ndërgjegjësohuni se çdo person që shpreh dëshirën për të aplikuar, kthehet në aplikant me të gjitha të drejtat e përcaktuara

Përcilleni kërkesën tek autoritetet kompetente për t'u regjistruar

Shënojeni nëse jeni kompetent për të kryer këtë

Informoni aplikantin se ku dhe si mund të paraqitet kërkesa

Çfarë duhet të bëni nëse personi nuk dëshiron të aplikojë

Sigurohuni për parimin e ndalimit të dëbimit

Informoni përsëri mbi mundësinë për të aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare dhe vini në dukje pasojat e mos aplikimit

Kur jeni në dyshim, konsultohuni me eprorin tuaj

Ndiqni procedurat shtetërore të vendit tuaj për të vepruar me hapat e mëtejshme

Parime të përgjithshme

Urgjencat shëndetësore dhe nevojat bazike janë çështjet parësore për t'u trajtuar

Personat e cenueshëm duhet të identifikohen dhe të mbështeten në mënyrë adekuate

Përparësi gëzon interesi më i mirë i fëmijës kur bëhet fjalë për çështje të lidhura me ta

Varianti elektronik i tekstit mund të gjendet në faqet e mëposhtme të internetit të EASO dhe Frontex, së bashku me mjete të tjera praktike për zyrtarët përgjegjës të kontaktit të parë lidhur me aksesin në procedurën e azilit:

<http://easo.europa.eu/accesstoprocedure>

<http://frontex.europa.eu/publications/?c=training>



■ Publications Office
of the European Union